




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË:	10/10/2024
REFERENC - Ë:	09/Zyrtare/2024
PER/ZA/TO:	zpj. Arbënesha Kuqi – Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
NGA/OD/FROM:	Pjeter Frrokaj – Udhëheqës i Sektorit të Hapësirave Publike
CC:	z.. Ardian Gjini - Kryetar i Komunës së Gjakovës
Përmes:	z. Nikollë Lleshi – Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike 
TEMA:	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Gjakovës.

Më lejoni të ju informoj, që implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Gjakovës, është aprovuar në Asamble Komunale sipas buxhetit dhe implementimet sipas KAB.

Gjatë periudhës së parë të vitit 2024, gjegjësisht periudhën kohore Janar - shtator janë realizuar:

NDËRTIMI I PARQEVE: Gjatë kësaj periudhe janë investuar në këto parqe në Komunën e Gjakovës,

Parku në fshatin Hereq,
Parku në fshatin Cërmjan,
Parku në fshatin Rogove,
Parku në fshatin Molliq,
Parku në fshatin Gerqine,
Parku në fshatin Muhader,
Parku të objekti i Kadastres,

Muri mbrojtës në fshatin Muhader, muri me vazo betoni te Ura e Islam Begut.
Investimet në këto parqe kapin shumen 250,000.00 Euro dhe pas përfundimit të kësaj kontrate Komuna e Gjakovë ka lidhur kontrata e re e cila do të merret kryesisht me trajtimin e hapsirave publike, totuaret, parqet e reja, parkingjet, shetitoren e lumi krena, dhe hapsirave tjera publike në nivel Komunal, gjithashtu në rrugen Bujar Roka po bëhet tajtimi dhe rregullimi i oazave per mbjelljen e fidaneve gjatë keti sezoni.

VENDOSJA E ULESEVE NË PARQE, SHPORTAVE DHE KAPAKEVE TË

PUSETAVE, Komuna e Gjakovës ka investuar:

Në hapesirat publike, në zonen urbane dhe rurale janë vendosur, ulse, shporta të mbeturinave, kapake të pusetave, vazo betoni, sfera betoni ant-parking. (Shuma e investimeve për këtë periudhe është 58,000.00 Euro.

Sipas prioriteteve dhe kërkesave të qytetarëve është bërë shpërndarja e ulseve dhe shportave të mbeturinave, në fshatin Skivjan, Novosellë e Ulët, Meje, Rracaj, Rogove, lagje Mulla Jusufi dhe Parku i Qytetit. Ndërsa kapakët e pusetave janë vendosur kryesisht në zonën urbane gati në të gjitha rrugët sipas kërkesave të qytetareve dhe sipas nevojave në të gjitha vendet e nevojshme.

SANIMI DHE SHTRIMI I RRUGËVE ME ZHAVORR NË ZONAT RURALE

Gjatë kësaj periudhe është bërë sanimi i rrugës në Brekoc, Lugbunar, Qerim, Raq/Shkugëz, ku shuma e investimit kap rreth 25,000.00 Euro. Poashtu kemi vazhduar ne fshatin Bec.

FURNIZIMI ME FIDANE TE DRUNJEVE DEKORATIV

Në gjithë teritorin e Kumunës së Gjakovës, gjatë përiudhës së parë të vitit 2024, është brë mbjellja e drynjëve dekorativ, në të gjithë hapësirat publike në Kumunën e Gjakovës, si: Fshati Hereç, fshati Skivjan, fshati Mulliq, fshati Stubell, fshati Bec, fshtai Shqiponjë, fshati Bistazhin, nëpër shkollat e Komunës së Gjakovës, ale, parqe dhe oaza të gjelbërtë. Po ashtu është bërë mbjellja e drujve dekorativ në oazat e rrugës N.Tereza, Gj.Sokoli dhe dalja e re nga IMN gjer në fshatin Osek Hile, parkun e qytetit dhe ë gjitha hapësirave tjera publike. Shuma e investimeve perafersisht kap vleren 67.550.00 euro.

Mbjellja e fidaneve po vazhdon sipas nevoje dhe kerkesave per furnizim.

SANIMI DHE NDERTIMI I VARREZAVE TE DESHMOREVE

Komuna e Gjakovës ka përfunduar ndërtimin e varrezat të Dëshmorëve në qytetit e Gjakovës, ku deri me tani vlera e investimeve për realizimin e gjithë projektit është 85.000,00 €.

